

EVIDENTIM I SITUATËS SË SHËRBIMEVE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

BASHKIA FIER

STATISTIKA

Numri i personave me aftësi të kufizuara në bashkinë Fier është 6142, prej të cilëve, 3212 janë të rregjistruar dhe përfitojnë nga pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar në Bashkinë Fier, ndërsa 2930, janë përfitues nga skemat e Sigurimeve Shoqërore për invalidët e punës.

Mazhoranca e përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar janë meshkuj (n=975; 71%).

22.8% (n=735) e përfituesve nga skemat e pagesave të mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Fierit, janë fëmijë të moshës 0-18 vjeç.

758 persona me aftësi të kufizuara janë edhe përfitues të pagesës së kujdestarisë, 64 prej tyre fëmijë.

SHËRBIMET E OFRUARA NË BASHKINË FIER

Qendra Ditore për Personat me Aftësi të Kufizuara "Horizont"

Në territorin e Bashkisë Fier ushtron aktivitetin vetëm një qendër ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara, e cila mbështetet dhe funksionon në ambientet e vëna në dispozicion nga Bashkia Fier. Qendra ofron shërbim ditor për fëmijë me aftësi të kufizuara. 80 klientë me aftësi të kufizuara marrin shërbim në këtë qendër, të gjithë fëmijë. Qendra Ditore ofron këto shërbime: mbështetje psiko sociale, pavarësi praktike, fizioterapi, ergoterapi, logopedi, arsim i mbështetur, laborator arti dhe laborator i artit pamor. Stafit është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha nevojat e klientëve. Aktualisht kemi punonjës social, psikolog, sociolog, infermjere, mësues mbështetës, terapist zhvillimi, edukatorë. Përfituesit janë kryesisht me aftësi të kufizuara intelektuale.

NEVOJA PËR SHËRBIME

Vetëm 1,3%,(n= 80) persona me aftësi të kufizuara, në Bashkinë Fier, marrin shërbime pranë qendrës Horizont.

Kjo tregon mbi nevojën për shtimin e gamës së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, si fëmijë ashtu edhe të rritur, si në numër, por edhe në llojshmëri, me qëllim që t'i vijë në ndihmë të gjithë individëve në nevojë në territorin e Bashkisë Fier.

